




REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA PROTIV KORRUPSIONIT ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. Dep.	2-D/DPK
Nr. i ftoq. Broj stranica Nr. pages	02
Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	01-249/15
Data Datum Date	30-01-2015
PRISHTINE	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 30.01.2015, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK- 03 - 4690/14, për z. Fadil Bunjaku – Drejtor i Departamentit të Administratës në Agjencinë për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar, për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, nr. AKK – 03-4690/14, për z. Fadil Bunjaku – Drejtor i Departamentit të Administratës në Agjencinë për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin Nr. 04/L-051 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Në këtë rast zyrtari i lartë z. Bunjaku, është hetuar për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, si zyrtar i lartë në Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar dhe njëkohësisht pronar në biznesit privat “BUNJAKU COMMERC”.

Fillimisht zyrtari i lartë është njoftuar me shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, për fillimin e procedurës së shqyrtimit të gjendjes së konfliktit të interesit, ndërsa më pas është takuar me zyrtarët e Agjencisë për t'i sqaruar situatën në të cilën ndodhet dhe për ndryshimet që duhet të bëj, në mënyrë që të shmangë situatën e konfliktit të interesit.

z. Bunjaku është bindur për kufizimin si pronar në biznesin privat dhe ka pranuar rekomandimin e Agjencisë për ti bërë ndryshimet e nevojshme për të shmangur konfliktin e interesit.

Ndërkohë ka dërguar në Agjenci shkresën zyrtare, të lëshuar nga Agjensioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (DPKI 03 – 132/15), me të cilën vërtetohet se ka bërë ndryshimet e nevojshme. Me këtë ka shmangur situatën e konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

II. Në pajtim me nenin 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik;
- Drejtorit të DPK- së;
- Z./znj. (zyrtarit përgjegjës).

Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

Hasan Preteni

